KËRKESË
Nr. 476/10, datë 12.8.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për projektin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 94, datë 12.2.2025, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i segmentit rrugor 'Shën Gjergji'–'Naun Kaçaku' (ish-ura me shkallë–stacioni i Patosit), Fier'"".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i projektit, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 94, datë 12.2.2025, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i segmentit rrugor 'Shën Gjergji'–'Naun Kaçaku' (ish-ura me shkallë–stacioni i Patosit), Fier'"", emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera paraprake e shpronësimit është 295,255 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË SË NEGOCIMIT
DHE ASISTENCËS LIGJORE
Denada Dosti

LISTA PARAPRAKE E BASHKËPRONARËVE, PASURIA E TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 94, DATË 12.2.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT RRUGOR 'SHËN GJERGJI'–'NAUN KAÇAKU' (ISH-URA ME SHKALLË–STACIONI I PATOSIT), FIER'""

Nr.	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim							Shënime (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
								"Truall"			"Ndërtesë"			Vlera totale	
	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	"Truall" (m^2)	"Ndërtesë" (m^2)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
19	Eugjen Themi Dëma Suzana Themi Rezhda Pranvera Themi Beka Ylli Themi Dëma Mimoza Themi Veli	8531	14/2	Truall	600	600	105.00	23.7	12,458.00	295,255				295,255	
VLERA TOTALE PARAPRAKE														295,255	